

VENDIM
Nr. 124, datë 11.5.2021

MBI RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 14, DATË 20.1.2021, “MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË ‘ENERGY SUPPLY - AL’ SHPK, NR. 115/310, SERIA F11/FK15, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të “Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 4, pika 1, germa “d”, nenit 5, pika 1, germa “d”, dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.5.2021, pasi shqyrtoi relacionin nr. 68/1 prot., datë 4.5.2021, të për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me plotësimin e kushteve të vendimit nr. 14, datë 20.1.2021, mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- ERE, me vendimin nr. 14, datë 20.1.2021, vendosi:

“1. Të rinovojë licencën e furnizimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k., miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, datë 2.2.2011, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 4.2.2021, me kusht që përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së licencuar të depozitojë në ERE:

a. vërtetimet përkatëse të gjykatës dhe prokurorisë për përfaqësuesin me prokurë;

b. dokumentacion vërtetues ku të shprehen qartë vlerat monetare dhe aftësia paguese e shoqërisë mëmë që ka marrë përsipër të mbështesë shoqërinë “Energy Supply - AL” sh.p.k. apo strukturën e financimit;

c. sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët, për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi;

d. dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’i ofrohen klientëve.

2. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, pasi të analizohet dokumentacioni i përcjellë nga shoqëria “Energy Supply - AL” sh.p.k. sipas kërkesave të pikës 1, të këtij vendimi.”.

-Në vijim të sa më sipër, ERE iu drejtua shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k., me shkresën nr. 128 prot., datë 26.1.2021, duke i njoftuar vendimet përkatëse.

- Shoqëria “Energy Supply - AL” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1855/5 prot., datë 29.1.2021, ka përcjellë argumente dhe një pjesë të dokumentacionit, në kuadër të plotësimit të kushteve të vendimeve të licencimit. Duke qenë se u konstatua ende mungesë, ERE iu drejtua sërish shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k. me shkresën nr. 299, datë 11.2.2021, ku i ka kërkuar sërish plotësimin e dokumentacionit që ka të bëjë me kushtet e vendimeve të rinovimit të licencave. Shoqëria vijoi plotësimin kryesisht të dokumenteve, në përmbushje të kushteve të vendimeve të rinovimit të licencave të saj, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 299/1 prot., datë 16.2.2021. Duke qenë se nevojitej ende dokumentacion, ERE, me shkresën nr. 299/2 prot., datë 25.2.2021, iu drejtua sërish shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k.. Kjo e fundit, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 299/4 prot., datë 11.3.2021, përcolli një pjesë të dokumentacionit të munguar dhe si e tillë ERE iu drejtua sërish me shkresën nr. 299/5, datë 29.3.2021, duke përsëritur

kërkesën e saj. Në përgjigje të sa kërkuar, shoqëria “Energy Supply - AL” sh.p.k., me shkresën nr. 299/6, datë 21.4.2021, përcolli dokumentacionin e munguar.

- Nga analizimi i dokumentacionit të përcjellë në ERE nga shoqëria “Energy Supply - AL” sh.p.k., në kuadër të plotësimit të kushteve të vendimeve nr. 13/2021 dhe nr. 14/2021, rezulton si më poshtë:

- kushti i vendosur në pikën 1, germa “a”, “Vërtetimet përkatëse të gjykatës dhe prokurorisë për përfaqësuesin me prokurë”, të vendimit nr. 14/2021, është plotësuar nga shoqëria “Energy Supply - AL” sh.p.k.;

- kushti i vendosur në pikën 1, germa “b”, “Dokumentacion vërtetues ku të shprehen qartë vlerat monetare dhe aftësia paguese e shoqërisë mëmë që ka marrë përsipër të mbështesë shoqërinë ‘Energy Supply - AL’, apo strukturën e financimit”, të vendimit nr. 14/2021, është plotësuar nga shoqëria “Energy Supply - AL” sh.p.k.;

- kushti i vendosur në pikën 1, germa “c”, “Sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi”, të vendimit nr. 14./2021, është plotësuar nga shoqëria “Energy Supply - AL” sh.p.k.;

- kushti i vendosur në pikën 1, germa “d”, “Dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’i ofrohen klientëve”, të vendimit nr. 14/2021, është plotësuar nga shoqëria “Energy Supply - AL” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të ndryshojë pikën 1, të vendimit të ERE-s nr. 14, datë 20.1.2021, si vijon:

Të rinovojë licencën e shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k., me nr. 115/310, seria F11/FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 5, datë 2.2.2011, dhe rinovuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 123, datë 14.10.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 4.2.2021.

2. Germat: “a”, “b”, “c”, “d”, të pikës 1 dhe pika 2, të vendimit nr. 14/2021, shfuqizohen.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti